



FEDERATA SHQIPTARE E PESHKIMIT SPORTIV

ALBANIAN FEDERATION OF SPORT FISHING

Prot. _____

Tiranë më, 08/04/2025

Drejtuar: **Shoqata “The Best Fishing Albania”**

Për dijeni: **Klubet anëtare të FSHPS**

Lënda: **Vendim për pezullimin e anëtarësisë**

I nderuar Z. Hoxha,

Në datën **8 Prill 2025** u mbledh Komiteti Drejtues i FSHPS dhe pasi u njoh me listat e anëtarëve të klubeve për tu federuar në FSHPS për vitin 2025 si dhe plotësimin e detyrimeve që kanë klubet ndaj FSHPS sipas **Nenit 4, Nenit 7** të Statutit të FSHPS si dhe vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të FSHPS mbajtur në datën 28 Mars 2025:

K O N S T A T O I

1. Shoqata “The Best Fishing Albania” nuk ka dorëzuar listën e anëtarësisë për tu pajisur me kartat e federimit për vitin 2025.
2. Shoqata “The Best Fishing Albania” nuk ka paguar kuotizacionin pranë FSHPS për vitin 2025 sipas vendimit të Asamblesë së Përgjithshme mbajtur në datën 28 Mars 2025.

Për këtë arsye Komiteti Drejtues i FSHPS:

V E N D O S I

1. Pezullimin e anëtarësisë për Shoqatën “The Best Fishing Albania” sipas **Nenit 8** të Statutit të FSHPS.
2. Ndalimin e përdorimit të logos së FSHPS në bluza, uniforma, website, shkresa, rrjete sociale dhe aktivitetet sportive të organizuara nga shoqata juaj.
3. Komiteti Drejtues i kërkon Asamblesë së Përgjithshme të FSHPS heqjen e anëtarësisë së Shoqata “The Best Fishing Albania” për shkelje të statutit të FSHPS dhe vendimeve të mara nga Asambleja e Përgjithshme.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ERVIN BOGDANI

SEKRETAR I PERGJITHSHEM